



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli  
Konsultativ**



**Procesverbali i Mbledhjes**

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore  
Mbledhja e datës 17 mars 2026**

## **Tabela e Përmbajtjes**

Hapja e mbledhjes.....	1
1. Projektligji “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”.....	2
Shtojcë: Të pranishëm .....	5

### **Hapja e mbledhjes**

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 17 mars 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ. Mbledhja u zhvillua online, në platformën zoom, Microsoft Teams. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi zëvendësministrat pjesëmarrës, shoqatat e bashkive dhe të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

## **PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA**

### **1. Projektvendimi “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”**

Znj. Greca, Drejtoreshë e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, prezantoi projektvendimin “*Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike*”. Ajo theksoi se vendimi do të kalojë përmes Ministrit të Pushtetit Vendor, pasi prek drejtpërdrejt bashkitë dhe u vlerësua i nevojshëm për shkak të problematikave në territor lidhur me përdorimin e hapësirave publike. Si bazë është marrë një rregullore e ngjashme e bashkisë Tiranë, e cila është përpunuar me një strukturë më të qartë, me qëllim zbatimin më efektiv dhe përfshirjen e të gjitha llojeve të përdorimit të hapësirave publike. Akti është konsultuar me disa bashki dhe janë reflektuar komentet e tyre.

Znj. Muraku, Drejtoreshë Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit theksoi se akti synon një rregullim të qëndrueshëm të hapësirave publike, duke rritur transparencën në procedurat e dhënies së lejeve nga bashkitë. Këshilli bashkiak përcakton tarifat bazuar në sipërfaqen e shfrytëzuar, kohëzgjatjen, zonën dhe natyrën e aktivitetit. Aplikimi kryhet në portalin e-Albania, sipas një formati tip dhe dokumentacioni shoqëruet.

Bashkia administron një regjistër elektronik të unifikuar të lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike. AKPT, në bashkëpunim me AKSHI dhe ASIG, do të ndërtojë një hartë interaktive të hapësirave publike, ku qytetarët mund të informohen mbi hapësirat e lira, ato të zëna me leje dhe tarifatat përkatëse.

Akti përcakton parimet themelore si:

- prevalimi i interesit publik,
- akses i lirë i qytetarëve,
- mbrojtja e mjedisit dhe identitetit urban,
- mirëmbajtja dhe kthimi i hapësirës në gjendjen fillestare,
- transparenca përmes regjistrit të lejeve,
- përputhshmëria me legjislacionin në fuqi.

Shfrytëzimi i hapësirave publike bëhet vetëm me leje nga bashkia. Parashikohet edhe detyrimi për mbjelljen e një peme, në varësi të aktivitetit dhe hapësirës së përdorur, veçanërisht për aktivitetet gastronomike.

Procedura parashikon:

- vlerësim paraprak brenda 7 ditëve;
- afat maksimal 15 ditë për dhënien e lejes.

Aplikimi shoqërohet me genplan ose skicë nga ekspert i licencuar dhe fotografi të hapësirës, me detyrimin për rikthimin në gjendjen fillestare pas përfundimit të aktivitetit.

Tarifat përcaktohen nga këshillat bashkiakë sipas zonës dhe përditësohen çdo vit. Masat ndëshkuese përfshijnë:

- paralajmërim dhe procesverbal;
- gjoba nga 15,000 deri në 35,000 lekë/m<sup>2</sup>;
- sekuestrim të pajisjeve;
- pezullim aktiviteti;
- revokim leje dhe ndalim riaplikimi për 2 vjet.

Përcaktohet që vetëm 25% e trotuarëve mund të përdoren për aktivitete gastronomike, duke garantuar minimumi 200 cm hapësirë për këmbësorët. Lejet kanë afat 1-vjeçar, me mundësi vendimmarrjeje nga këshilli bashkiak për afate më të gjata.

Ndalohet vendosja e strukturave si:

- barriera ajri,
- pedana,
- elementë mbi gjelbërimin publik,
- bllokimi i korridoreve të qarkullimit.

Lejohet ekspozimi i mallrave jashtë fasadave vetëm si plotësim i aktivitetit ekzistues (p.sh. fruta-perime). Për tregjet sezonale, bashkia përcakton vendndodhjen dhe lejet mund të jenë edhe më të shkurtra se 3 muaj. Janë të vlefshme vetëm për një subjekt dhe janë të patransferueshme. Për strukturat e përkohshme (kioska, rulota), leja jepet deri në 1 vit, pa fiksime të përhershme në tokë dhe rinovohet 45 ditë para skadimit.

Për reklamat dhe tabelat LED:

- duhet të respektohen kriteret e sigurisë dhe ndriçimit;
- kërkohet miratim i administratorit të objektit;
- duhet të paraqitet pamja vizuale.

Për aktivitete si panaire:

- aplikimi bëhet 45 ditë para zhvillimit;
- kërkohet plan i detajuar;
- bashkëpunim me policinë bashkiake dhe zjarrfikësen;
- plan evakuimi;
- miratim paraprak nga Ministria e Kulturës.

Hapësira duhet të pastrohet brenda 2 orëve dhe të rikthehet në gjendjen fillestare brenda orës 06:00 të ditës pasuese.

Për aktivitetet kulturore:

- lejet janë afatshkurtra;
- sigurohet hapësirë minimale për këmbësorët;
- në rast shkeljeje, ndalohet aktiviteti deri në 2 vjet.

Për plazhet, rregullorja harmonizohet me legjislacionin sektorial dhe VKM nr. 649/2024.

Znj. Mersini, Kryetare e bashkisë Vlorë ngriti shqetësimin mbi aplikimin në sistemin e-Albania, si dhe problematikat që lidhen me lavazhet dhe serviset pranë zonave të banuara.

Znj. Greca sqaroi se rregullorja ka në fokus vetëm hapësirat publike dhe se çështje të tilla si lavazhet nuk janë objekt i saj, por i kompetencave të bashkive.

Znj. Vjero ngriti disa çështje thelbësore:

- nevojën për harmonizimin e tarifave me legjislacionin për taksat vendore;
- saktësimin e afateve të lejeve;
- krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik;
- përcaktimin e qartë të përgjegjësive të strukturave zbatuese.

Gjithashtu, znj. Vjero sugjeroi rishikimin e nivelit të gjobave dhe përcaktimin e tyre në mënyrë më të qartë dhe proporcionale.

Znj. Katerina Marku, Drejtor në bashkinë Tiranë, theksoi rëndësinë e vendosjes së kriterëve për llojin e pemëve që do të mbillen, në funksion të biodiversitetit urban.

Znj. Farrici ngriti shqetësimin mbi përfshirjen e bashkive në hartimin e rregullores dhe sugjeroi fleksibilitet në përcaktimin e gjobave dhe tarifave, sipas specifikave të secilës bashki.

Znj. Iva Beharaj, përfaqësuese e bashkisë Tiranë, kërkoi sqarime për trajtimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, duke theksuar nevojën për lehtësira për subjektet jofitimprurëse duke reduktuar tarifatat deri 100%.

Znj. Muraku theksoi se çdo subjekt që shfrytëzon hapësirë publike duhet të ketë detyrime financiare dhe se menaxhimi i fondeve është i përcaktuar për të gjitha kategoritë.

Znj. Erselda Sefa, Kryetare e bashkisë Lushnjë, ngriti çështjen e trajtimit të bareve dhe restoranteve me struktura të përkohshme.

Z. Gjikutria, Sekretar i Përgjithshëm, bashkia Himarë parashtrij pyetjen mbi përdorimin e fondeve të gjeneruara nga shfrytëzimi i hapësirave publike dhe mbi respektimin e afateve procedurale.

Znj. Laura Deliu, Drejtor i Përgjithshëm i Taksave Vendore në Bashkinë Tiranë, ngriti shqetësimin për mungesën e parashikimeve lidhur me regjistrimet ekzistuese dhe nevojën për dispozita kalimtare.

Z. Dalipi theksoi rëndësinë e përfshirjes së shoqatave dhe nevojën për përshpejtimin e procesit të miratimit të dokumentit.

Përfaqësues nga Policisë Bashkiake, ngriti çështje mbi kompetencat për masat ndëshkuese, duke theksuar se sekuestrimi është një akt procedural dhe sugjeroi vendosjen e gjobave progresive.

Z. Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i komanduar, AMVV theksoi se dokumenti u është dërguar paraprakisht anëtarëve për shqyrtim.

Në përfundim, znj. Greca vlerësoi bashkëpunimin me bashkitë dhe kërkoi që të gjitha propozimet konkrete të dërgohen me shkrim, me qëllim përmirësimin e draftit përfundimtar të rregullores.

#### **Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje të zhvilluar me datën 17 mars 2026**

<b>Anëtarët e Këshillit Konsultativ</b>			
<b>Nr</b>	<b>Emri Mbiemri</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Institucioni/Organizata</b>
1	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
2	Arian Jaupllari	Zv/ministër	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
3	Fran Brahimi	Drejtor	Ministria e Financave
4	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
5	Agron Ivanaj	Kryetar	Këshilli i Qarkut Lezhë
6	Pjerin Ndreu	Kryetar/Bashkia Lezhë	Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë

Bashkëlidhur mund të aksesoni linkun për aktin e diskutuar në mbledhjen e Këshillit Konsultativ datë 17 mars 2026

<https://qeverisjavendore.gov.al/17-mars-2026/> Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ E-mail: [keshilli.konsultativ@amvv.gov.al](mailto:keshilli.konsultativ@amvv.gov.al) Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.

